

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGTARE
"OCTA TRADE" Sh.p.k.**

Sot, më datë 27/11/2024 (dymijë e njezët e katër), ishte prezent personalisht ortakut themelues:

Kamelia Tafaj shtetas shqiptar, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, lindur me 29/12/1991, në Tiranë, banues në Tiranë, me adresë ne Rr. e "Kavajës", Nd. 229, H,1, Njësia Administrative nr. 7, 1023, Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit Nr. 036387437, me nr. Personal J16229054K, i cili ka vendosur të themeloj shoqërinë tregtare "OCTA TRADE" Sh.p.k, me kushtet si më poshtë:

NENI 1

Statusi Juridik

Shoqëria Tregtare "OCTA TRADE" Sh.p.k. është formuar si Shoqëri tregtare sipas ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar (në vazhdim referuar si "Shoqëria").

Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

Ajo ka formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2

Emri i shoqërisë


Shoqëria do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin "OCTA TRADE" Sh.p.k.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në:

- Konsulencë ligjore në fushën civile, tregtare, administrative dhe prokurimeve si dhe shërbime në fushën e avokatisë për personat fizik, juridik, ente publike etj.;
- Konsulencë në fushën e ndërtimit të objekteve civile dhe industriale si dhe në fushën e efencës së energjisë;
- Konsulencë financiare për persona personat fizik dhe juridik;
- Import, eksport dhe tregtim i materialeve elektrike, hidraulike, materiale ndërtimi, makineri dhe pajisje industriale, makineri të rënda, mjete motorrike të gjithë kategorive, pajisje elektroshtëpiake, sisteme kondicionimi dhe aspirimi, mobilje, kancelari, letra printerash dhe kasash fiskale, produkte ushqimore, pije alkoolike dhe joalkoolike, detergjent dhe produkte pastrimi, pajisje kompjuterike përfshirë printerat, fotokopje dhe skanera, pjesë këmbimi, goma dhe vajra lubrifikant për mjetet motorrike;
- Shërbim bar, restorant dhe hoteleri;
- Dhënie me qera të mjeteve motorrike dhe pasurive të paluajtshme;



- Agjenci udhëtimi.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. e "Kavajës", pasuria nr. 6/324+3-6, zona kadastrale nr. 8220, Tiranë, Shqipëri.

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100,000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale të një kuote prej 100,000 (njëqind mijë) lekë.

Kamelia Tafaj zotëron 1 kuotë të kapitalit themeltar të barabartë me 100% të tij në vlerën 100,000 (Njëqind mijë) Lekë.

Kapitali themeltar është investuar nga ortaku themelues në total.

NENI 6

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 7

Organet Drejtuese

Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve — organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratorët — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet nga Administratorët të cilët mund të zgjidhen për një afat deri në 5 (pesë) vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i Shoqërisë "OCTA TRADE" Sh.p.k, është **Z. Jaup Xhafa**, shtetas shqiptar, person madhor me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, lindur më 10/12/1991, në Selcë, identifikuar nga Pasaporta me Nr. BI3614210, dhe numër personal, J11210052E, i cili zgjidhet për një periudhë 5 (pesë) vjetecare, me të drejtë ripërtëritjeje.

Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i



cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 8

Ligji i aplikueshëm

Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga Ortaket Themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe që mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve të tyre me Shoqërinë, do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 10

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, dhe nënshkruhet nga ortaku themelues.

ORTAKU THEMELUES

Kamela Tafel
[Signature]